



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 janar 2023
Nr. ref.:RK 2106/22

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI132/21

Parashtrues

Ajsel Gashi, Fetije Gashi-Qeko, Sevim Gashi, Suad Gashi dhe Sylejman Gashi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit
[CN.nr.11/21], i 6 majit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

E përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gerxhaliu -Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ajsel Gashi, Fetije Gashi-Qeko, Sevim Gashi, Suad Gashi dhe Sylejman Gashi (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesit e kërkesës), nga Komuna e Prizrenit.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës e kontestojnë Aktvendimin [CN. nr. 11/2021] e 6 majit 2021, të Gjykatës së Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar të Gjykatës së Apelit, përmes të cilit pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).
4. Parashtruesit e kërkesës po ashtu i referohen nenit 24 të Kartës Sociale Evropiane.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 12 korrik 2021, parashtruesit e kërkesës e dorëzuan kërkesën e tyre përmes postës, të cilën Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës e pranoi më 14 korrik 2021 (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 26 korrik 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
8. Më 9 gusht 2021, Gjykata njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga parashtruesit që të nënshkruajnë formularin e kërkesës ose të dorëzojnë autorizimin për përfaqësim para Gjykatës, si dhe t' i dorëzojnë të gjitha vendimet e gjykatave të rregullta dhe ankesat kundër tyre.
9. Më 24 gusht 2021, parashtruesit e kërkesës dorëzuan një dokument të nënshkruar në Gjykatë, përmes të cilit dëshmuan se të gjithë nga ata janë parashtrues të kërkesës dhe vet përfaqësohen para Gjykatës.
10. Më 8 tetor 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
11. Më 27 tetor 2022, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i propozoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 28 janar 1958, I. B., në cilësinë e pronarit - kishte lidhur kontratën mbi dhuratën [Leg. nr. 74/58] me Komunën e Prizrenit për dhurim të ngastrës kadastrale [nr. 110/58], e cila ishte vërtetuar pranë Gjykatës së Rrethit në Prizren, dhe e cila tashmë kishte kaluar në pronësi të Komunës së Prizrenit.
13. Në një datë të pasaktësuar, E. K., përmes marrëveshjes për ndërrimin e pasurisë kishte dhuruar parcelën kadastrale [nr. 8670 ZK] Komunës së Prizrenit. Ndërsa kjo e fundit i kishte dhuruar E. K., si kompensim nga pasuria gjithë popullore parcelën kadastrale [9170], e cila i ishte dhënë si dhuratë nga I. K. Kjo marrëveshje ishte vërtetuar pranë Gjykatës Komunale të Prizrenit dhe tashmë parcela [9170] kishte kaluar në pronësi të E. K-së.
14. Më 22 shtator 1964, I.K. kishte vdekur.
15. Në një datë të pasaktësuar, trashëgimtarët e I. K., respektivisht S. K., I. K., M. K., R. K., N. B., E. M., dhe pala V. Gj., paraqitën padi në Gjykatën Komunale në Prizren, duke kërkuar anulimin e kontratës mbi dhuratën [Leg. nr. 74/58] të 28 janarit 1958, me arsyetimin se ishte lidhur nën presion dhe dhunë.
16. Më 7 maj 1996, Gjykata Komunale në Prizren përmes Aktgjykimit [P. nr. 991/95] anuloi kontratën mbi dhuratën [Leg. nr. 74/58] të 28 janarit 1958, për shkak të nulitetit absolut meqë ishte lidhur nën presion dhe dhunë.
17. Më 28 dhjetor 2000, Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Juridike e Komunës së Prizrenit përmes aktvendimit [nr. 03/3-463-225] kishte vendosur që trashëgimtarëve të I. K., t'ia kompensoj parcelën e trashëgimtarit I. K. që ia kishte dhuruar Komunës së Prizrenit, duke i dhuruar tashmë parcelën kadastrale [nr. 329/17].
18. Më 20 korrik 2001, Drejtoria për Çështje Pronësore dhe Juridike e Komunës së Prizrenit përmes aktvendimit [nr. 03/3-463-180] anuloi aktvendimin e mëparshëm duke kërkuar që parcela kadastrale [nr. 329/17] e ndarë në emër të kompensimit t'iu kthehet dhe të evidentohet në pronësi shoqërore në emër të ish-shfrytëzuesit të mëparshëm.
19. Në një datë të pasaktësuar, trashëgimtarët e I. K., iu drejtuan Gjykatës Komunale në Prizren, duke kërkuar dorëzimin e parcelës [329/1] nga Komuna e Prizrenit në emër të kompensimit.
20. Më 14 mars 2006, Gjykata Komunale në Prizren, përmes Aktgjykimit [C. nr. 937/05], aprovoi kërkesën e trashëgimtarëve të I.K., dhe detyroi Komunën e Prizrenit që t'ua dorëzojë parcelën kadastrale [329/1] sipas listës poseduese [244] trashëgimtarëve juridikë të I.K., dhe të lejoj regjistrimin e saj në emër të tyre.
21. Në një datë të pasaktësuar, Komuna e Prizrenit paraqiti ankesë në Gjykatën e Qarkut në Prizren kundër Aktgjykimit [C. nr. 937/05] të Gjykatës Komunale në Prizren duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave procedurale, vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 11 gusht 2006, Gjykata e Qarkut në Prizren përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 287/2006] refuzoi ankesën e Komunës së Prizrenit dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 937/05] e 14 marsit 2006 të Gjykatës Komunale në Prizren.

23. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesit e kërkesës iu drejtuan Gjykatës Themelore në Prizren me një kërkesëpadi duke kërkuar që të vërtetohet se parashtruesit e kërkesës janë bashkëpronarë me nga 1/10 pjesë e ngastrës kadastrale [nr. 329/1] dhe t'ju lejohet regjistrimi i pronës në emër të tyre. Parashtruesit e kërkesës arsyetuan se e drejta e bashkëpronësisë në ngastrën kadastrale [nr. 329/1] rrjedh nga e drejta në trashëgimi e paraardhëses së tyre Nergjivane Kovaqi-Gashi si trashëgimtare e ish-pronarit të parcelës [nr. 9170] Sejfulla Kovaqi.
24. Parashtruesit e kërkesës në kërkesën e tyre pretenduan fillimisht se parcela [nr. 9170] nuk ka qenë në pronësi të I. K., por në emër të babait të tij S. K., i cili pas vdekjes kishte lënë si trashëgimtar të birin I. K., dhe të bijën Nergjivane Kovaqi-Gashi, respektivisht paraardhëse/trashëgimlënëse e parashtruesve të kërkesës.
25. Më 26 gusht 2013, Gjykata Themelore në Prizren, përmes Aktgjykimit [C. nr. 648/2001], refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës me arsyetimin se palë kontraktuese e kontratës mbi dhuratën [Leg. nr. 74/58] të 28 janarit 1958, ka qenë I. K., në cilësinë e dhuratëdhënësit dhe rrjedhimisht prona kontestuese nuk ka qenë në emër të Sejfulla Kovaqit.
26. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën ankesë kundër Aktgjykimit [C. nr. 648/2001] të 26 gushtit 2013, të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale. Parashtruesit e kërkesës përmes plotësimit të ankesës theksuan se të drejtën e tyre e bazojnë mbi bazën e përfaqësimit prej Sejfulla Kovaqit.
27. Më 8 korrik 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 595/2014], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin [C. nr. 648/2001] e 26 gushtit 2013, të Gjykatës Themelore me arsyetimin se me asnjë provë materiale parashtruesit e kërkesës nuk e kanë argumentuar pretendimin se prona kontestuese [nr. 9170] ka qenë e regjistruar në emër të Sejfulla Kovaqit.

Kërkesa për përsëritjen e procedurës

28. Më 2 nëntor 2020, parashtruesit e kërkesës paraqitën propozimin për përsëritjen e procedurës në Gjykatën Themelore kundër Aktgjykimit [C. nr. 1648/2001] të 26 gushtit 2013, të Gjykatës Themelore në Prizren.
29. Gjykata vëren se as nga dosja e lëndës, por as nga vetë parashtruesit e kërkesës, nuk ka njohuri nëse Gjykata Themelore ka nxjerrë ndonjë vendim në lidhje me kërkesën e parashtruesit të paraqitur me 2 nëntor 2020.
30. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesit e kërkesës paraqitën kërkesë për përsëritjen e procedurës edhe në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit [C. nr. 1648/2001] të Gjykatës Themelore në Prizren. Gjithashtu, parashtruesit dorëzuan edhe plotësim ankesën, e cila mbanë datën e 4 shkurtit 2014.
31. Më 6 maj 2021, Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CN. nr. 11/21] duke u bazuar në nenet 327 dhe 239 të Ligjit nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore - hodhi poshtë si të palejuar propozimin për përsëritjen e procedurës me arsyetimin se kërkesa është paraqitur jashtë afatit ligjor.
32. Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj konkludoi se:

"[...] me zbatimin analog të dispozitave të LPK-së, lidhur me mjetet e jashtëzakonshme, nuk ka pengesë që gjykata e shkallës së dytë ta hedh si të palejuar propozimin për përsëritjen e procedurës, meqë një veprim i tillë nuk e ka ndërmarrë gjykata e shkallës së parë [...]"

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se gjykatat e rregullta kanë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe nenin 24 të Kartës Sociale Evropiane.
34. Parashtruesit e kërkesës përgjatë pretendimeve të tyre theksojnë: *"Paditësit Fetije (Qeko), Gashi, Ajsel Qeko-Gashi, Sevim Gashi, Suad Gashi dhe Sylejman Gashi me padi vazhdimisht kanë pretenduar se patundshmëria kontestuese, e cila ka qenë objekt i kontratës mbi dhuratën, (Leg. nr.74/53, dt. 28.12.1958), e anuluar me aktgjykimin plotfuqishëm të Gjykatës Komunale në Prizren C. nr. 991/95, dt. 07.05.1996, nuk ka qenë pronë e babait të të paditurve - Ibrahim Kovaqit (dajës së paditësve) - Selvinaz Kovaqit etj; por është pronë e gjyshit të palëve ndërgjyqëse Sejfulla Kovaqit, i cili ka pasur dy fëmijë babën e të paditurve Ibrahim Kovaqin dhe nanën e paditësve Nergjivane Kovaqi-Gashi"*.
35. Parashtruesi i kërkesës përfundon duke kërkuar nga Gjykata, *"Vërtetim i pronësisë mbi bazën e trashëgimisë"*.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrotjtja e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

Neni 46

[Mbrotjtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
2. Shfrytëzimi i pronës rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik.
3. Askush nuk do të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe

pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave eksproprijohet.

4. Kontestet që lindin nga akti i Republikës së Kosovës ose autoritetit publik të Republikës së Kosovës për të cilat pretendohet se përbëjnë eksproprijimin, do të zgjidhen nga gjykata kompetente.

5. Prona intelektuale mbrohet me ligj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Protokolli nr. 1 Neni 1 [Mbrojtja e Pronës]

1. Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare.

Ligji nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 237

237.1 Propozimin për përsëritjen e procedurës të paraqitur pas afatit ligjor, atë jo të plotë, apo të palejueshëm, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit pa mbajtur seancë gjyqësore.

[...]

Neni 239

239.1 Gjkata e shkallës së dytë vendosë mbi propozimin për përsëritjen e procedurës zakonisht jashtë seance për shqyrtim kryesor.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret për pranueshmëri të kërkesës, të përcaktuara në Kushtetutë dhe më tej të parapara në Ligj dhe të specifikuara në Rregullore të punës.

37. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. 1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

38. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç kërkohet me nenet 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individidi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht [...]”.

39. Gjykata më tej i referohet paragrafëve (1) (c) dhe (3) (b) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që parasheh:

(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit,

[...]

“(3) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm.

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën [...]”.

40. Gjykata rikujton se në lidhje me kërkesën e dorëzuar, parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [CN. nr. 11/21] të 6 majit 2021, përmes të cilit pretendojnë shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] dhe nenin 1 të protokollit 1 të KEDNJ-së, si dhe nenin 24 të Kartës Sociale Evropiane.

41. Gjykata, në vijim, do t'i trajtojë veç e veç secilin pretendim të parashtruesve të kërkesës, duke aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mbi bazën e të cilës Gjykata, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
42. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se praktika e GJEDNJ-së përcakton se drejtësia e një procedure vlerësohet në bazë të procedurës si tërësi (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykimi të 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68). Rrjedhimisht, gjatë vlerësimit të pretendimeve të parashtruesve të kërkesës, Gjykata gjithashtu do t'i përmbahet këtij parimi (shih rastin e Gjykatës KI104/16, *parashtrues Miodrag Pavić*, Aktgjykim i 4 gushtit 2017, paragrafi 38; dhe rastin KI143/16, *parashtrues Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2018, paragrafi 31).

Pretendimi për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

43. Gjykata fillimisht rikujton që parashtruesit e kërkesës kontestojnë Aktvendimin e Gjykatës së Apelit [CN. nr. 11/21] të 6 majit 2021, përmes të cilit pretendojnë shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i refuzimit të kërkesës se tyre për përsëritjen e procedurës kontestimore.
44. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës iu drejtuan Gjykatës së Apelit me kërkesën për përsëritjen e procedurës dhe anulim të Aktgjykimit [C. nr. 1648/2001] të Gjykatës Themelore në Prizren, përmes të cilit aktgjykim ishte vendosur lidhur me meritat e rastit dhe më pas ky aktgjykim ishte vërtetuar përmes Aktgjykimit [Ac. nr. 595/2014] të 8 korrikut 2019, të Gjykatës së Apelit.
45. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se Gjykata e Apelit përmes Aktvendimit [CN. nr. 11/21] të 6 majit 2021 hodhi poshtë si të palejuar propozimin për përsëritjen e procedurës me arsyetimin se kërkesa nuk i plotësonte kushtet nga neni 237 të Ligjit nr. 03/l-006 për Procedurën Kontestimore, përkatësisht kërkesa ishte paraqitur jashtë afatit ligjor.
46. Duke pasur parasysh këtë, Gjykata vëren se Gjykata Apelit, sipas kërkesës për përsëritje të procedurës gjyqësore të parashtruesve të kërkesës, vendosën ekskluzivisht për përmbushjen e kushteve procedurale për paraqitjen e kërkesës për përsëritje të procedurës gjyqësore, dhe jo për meritat e rastit.
47. Gjykata, duke pasur parasysh se procedura konkrete ka të bëjë vetëm me çështjet që lidhen me përsëritjen e procedurës kontestimore, thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës "*Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*."
48. Sa i përket pretendimit të parashtruesve të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata, duke iu referuar praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikës gjyqësore të saj, përsëritë se neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës. (Shih, në mënyrë analoge rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI159/15, *Sabri Ferati*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 qershorit 2016, paragrafi 37; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31, shih gjithashtu rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit

2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

49. Gjithashtu, Gjykata rikujton se neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet në përpjekjet e pasuksesshme për të rihapur një procedurë penale ose kontestimore, në bazë të fakteve të reja apo përmes procedurave të rishikimit të jashtëzakonshëm ose të posaçëm për arsye procedurale, të cilat nuk janë drejtpërdrejtë të disponueshme për personat fizikë dhe zbatimi i të cilave varet nga autorizimet diskrecionale të një autoriteti të caktuar (shih, Vendimin e GJEDNJ-së *Tumilovich kundër Rusisë*, kërkesa 47033/99, të 22 qershorit 1999).
50. Në këtë vazhdë, Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së, e cila parasheh: "... neni 6 i Konventës, nuk gjen zbatim, përderisa autoritetet vendore nuk pranojnë të rihapin një procedurë, madje edhe në ato raste ku parashtruesi kishte paraqitur kërkesën për rihapje të procedurës në sajë të një aktgjykimi të mëparshëm të Gjykatës me të cilin është vërtetuar se ka pasur shkelje të Konventës në lidhje me procedurën e kontestuar para gjykatave vendore (shih Aktgjykimin e GjEDNJ-së *Franz Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 37950/97, e 29 majit 2001). Megjithatë, në atë moment kur procedura rihapet ose kur aprovohet rishikimi i jashtëzakonshëm i procedurës, mekanizmat mbrojtës nga neni 6 i Konventës zbatohen për tërë procedurën gjyqësore (shih, Vendimin e GjEDNJ-së *Vanyan kundër Rusisë*, kërkesa 53203/99, e 15 dhjetorit 2005, paragrafët 56-58).
51. Gjykata konsideron se pajtueshmëria *ratione materiae* e kërkesës me Kushtetutën rrjedh nga juridiksioni material i Gjykatës. "E drejta në të cilën thirret parashtruesi i kërkesës duhet të mbrohet me Kushtetutë në mënyrë që një ankesë kushtetuese të jetë në pajtueshmëri *ratione materiae* me Kushtetutën". (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31).
52. Prandaj, Gjykata konsideron se ankesat/prendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me refuzimin nga Gjykata e Apelit për të përsëritur procedurën nuk janë *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.

Pretendimi për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

53. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës pretendojnë shkelje të të drejtave pronësore në ngastrën kadastrale [nr. 329/1] mbi bazën e trashëgimisë së paraardhëses së tyre Nergjivane Kovaqi-Gashi, në cilësinë e trashëgimtares së ish-pronarit të parcelës [nr. 9170], Sejfulla Kovaqi.
54. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se parcela [nr. 9170] nuk ka qenë në pronësi të I. K., por në emër të babait të tij S. K., i cili pas vdekjes kishte lënë si trashëgimtar të birin I. K., dhe të bijën Nergjivane Kovaqi-Gashi, respektivisht paraardhëse/trashëgimlënëse e parashtruesve të kërkesës.
55. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës pretendojnë të drejtat pronësore mbi pronën kontestuese në cilësinë e trashëgimtarëve të Nergjivane Kovaqi-Gashi si pasardhëse e ish-pronarit të parcelës [nr. 9170], Sejfulla Kovaqi.
56. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës në esencë pretendojnë se mosaprovimi i kërkesës për përsëritjen e procedurës nga ana e Gjykatës së Apelit përmes Aktvendimit [CN. nr. 11/21] të 6 majit 2021, dhe dështimi i gjykatave të

rregullta, që të vërtetojnë/konfirmojnë të drejtat pronësore mbi pronën kontestuese përbën shkelje të nenit 46 të Kushtetutës.

57. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës përgjatë gjithë procesit gjyqësor të zhvilluar para gjykatave të rregullta kërkonin të drejtat pronësore mbi pronën duke pretenduar se I. K., nuk ka qenë pronar i parcelës [nr. 9170] e kompensuar më vonë me parcelën [329/1] por parcela [nr. 9170] ishte në emër të S. K., babai i I. K. dhe Nergjivane Kovaqi-Gashi.
58. Në këtë aspekt, Gjykata vëren se procedura ndaj parashtruesve të kërkesës e zhvilluar para gjykatave të rregullta në lidhje me kërkesëpadinë e tyre për vërtetim të të drejtës në pronë, ku ishte trajtuar në merita dhe pretendimi i tyre lidhur me të drejtat pronësore mbi pronën kontestuese kishin përfunduar me Aktgjykimin [Ac. nr. 595/2014] e Gjykatës se Apelit, të 8 korrikut 2019, i cili kishte konfirmuar në tërësi Aktgjykimin [C. nr. 648/2001] e Gjykatës Themelore, të 26 gushtit 2013, që kishte hedhur poshtë kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës për të drejtat pronësore mbi pronën kontestuese.
59. Rrjedhimisht, si "vendim i fundit", sipas nenit 49 të Ligjit është Aktgjykimi [Ac. nr. 595/2014] i Gjykatës se Apelit, të 8 korrikut 2019, me të cilin ishte refuzuar kërkesëpadia e parashtruesit kundër Aktgjykimin [C. nr. 648/2001] e Gjykatës Themelore, të 26 gushtit 2013 (shih, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI112/19, parashtrues *Illir Kabashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 2 dhjetorit 2019, paragrafi 43)
60. Andaj, Gjykata rikujton se Aktgjykimi [Ac. nr. 595/2014] i Gjykatës se Apelit ishte nxjerr më 8 korrikut 2019. Edhe pse parashtruesi nuk ka cekur datën e pranimit të këtij vendimi, nga faktet e rastit, është e qartë se koha në mes të pranimit të aktgjykimit dhe të datës së dorëzimit të kërkesës së tij, më 12 korrik 2021, në Gjykatën Kushtetuese, ka kaluar periudhën kohore prej 4 (katër) muajsh.
61. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej 4 (katër) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe të parandalohet mbajtja në gjendje pasigurie për një periudhe të gjatë kohore e palëve dhe personave të tjerë të përfshirë në procese gjyqësore (shih, *mutatis mutandis* rastin Sabri Güneş kundër Turqisë, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i GJEDNJ-se, i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; dhe, rastin e Gjykatës Kushtetuese nr. KI140/13, *Ramadan Cakiqi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24).
62. Rrjedhimisht, Gjykata arrin në përfundim se ky pretendim i parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave të tyre pronësore, të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, është i pasafatshëm në kuptim të nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, dhe si e tillë kjo pjesë e kërkesës është e papranueshme.
63. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkesa si tërësi deklarohet e papranueshme, në pajtim me paragrafin 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe rregullin 39 (1) (c) dhe 39 (3) (b) të Rregullores së punës.
64. Rrjedhimisht:
 - (i) në lidhje me pjesën e kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës si rezultat i refuzimit të propozimit për përsëritjen e procedurës

në lidhje me meritat e kërkesës për të cilin tashmë është vendosur, kërkesa nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetutën;

- (ii) në lidhje me pjesën tjetër të kërkesës përkitazi me pretendimin për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, është jashtë afatit.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 dhe 49 të Ligjit dhe të rregullit 39 (1) (c) dhe 39 (3) (b) të Rregullores së punës, më 27 tetor 2022, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani